

Testi i shikimit

Kind en Gezin (Fëmija dhe Familja) ofron teste të shikimit në klinikat e tyre për fëmijët e moshave 12 deri 15 muaj dhe 24 deri 30 muaj.

- Testimi i shikimit dallon probleme te sytë dhe faktorë që mund të çojnë në "sy dembel".
- Shikimi i fëmijës vazhdon të zhvillohet deri në moshën 7 apo 8 vjeç. Në mënyrë që sytë e fëmijës tuaj të zhvillohen mirë, është e nevojshme të dallohen herët problemet e syve dhe të trajtohen siç duhet nëse është e nevojshme. Kjo i jep fëmijës tuaj mundësitë më të mira që të zhvillohet.
- Testi i shikimit është i parrezikshëm, pa dhimbje, pa vështirësi për fëmijët dhe falas.

Kush e bën testin e shikimit dhe kur?

Testi i shikimit bëhet duke përdorur një pajisje që duket si një kamera. Infermierja rajonale e mban këtë pajisje rreth një metër larg nga fëmija juaj, që duhet të shikojë direkt te kamera.

Fëmija mund të ulet në prehrin tuaj dhe vëmendja e tij apo e saj mund të tërhiqet duke përdorur një fytyrë që buzëqesh ose një zhurmë tingëlluese.

Kind en Gezin dallon problemet me sytë brenda vitit të parë të jetës së fëmijës tuaj. Do të nevojiten kontrole edhe pas kësaj kohe.

Centrum voor Leerlingenbegeleiding (CLB, Qendra për Udhëzimin e Nxënësve) ofron vizita të mëtejshme për problemet me sytë.

Çfarë ndodh nëse testi i shikimit ka rezultate negative?

Më pas fëmija juaj referohet te një okulist. Okulisti do të vendosë nëse ndjekja e më pasme është e nevojshme dhe nëse fëmijës tuaj i nevojitet trajtim.